

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Mijëra njerëz protestojnë në Prishtinë kundër dënimit të ish-krerëve të UÇK-së për krime lufte
ADRESA	https://boldnews.al/2026/09/18/mijera-njerez-protestojne-ne-prishtine-kunder-denimit-te-ish-krereve-te-uck-se-per-krime-lufte/
BURIMI	boldnews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 11:50:24 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 11:45:37 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e51e08065e204eaa36cae047e7aacba836fe95405b22a47df7c5486a2742c9da
TEKSTI	627c5c668682510ebb51b320891641084770009fb6c89664b704d8a74e6f8706
PAMJA	2b2b6c9e28e371ee883cc89d243427f8ededcaa3ddfdac7f71d2cfcdd60b0b35

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	c66f426da4340c11af4c0930d1d7e02a947a8c14be5576906f3b5a67738ef6af
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	4f41e4bbd5d1a7a4ac13493ee37230fd53ce6e6428b4fbf05933a9d422fc171d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/c66f426da4340c11af4c0930d1d7e02a947a8c14be5576906f3b5a67738ef6af>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fillimi > AKTUALITET

Mijëra njerëz protestojnë në Prishtinë kundër dënimit të ish-krerëve të UÇK-së për krime lufte

13:45 : 18/09/2026 në AKTUALITET, RAJONI



Mijëra qytetarë u mbledhën të premten në kryeqytetin Kosovës duke e kundërshtuar dënimin me burgim për krime lufte të katër ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) nga Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë ditë më parë.

Ata shpallorën një sërë kërkesash për institucionet e vendit, përfshirë, shfuqizimin apo ndryshimin e ligjit për Dhomat e Specializuara.

Hashim Thaçi, Kadi Veseli, Jakup Krasniqi e Rexhep Selimi, të cilët udhëhoqën UÇK-në gjatë luftës së saj kundër forcave serbe më 1998-99, u shpallën fajtorë më 16 shtator nga ajo që njihet edhe si Gjykata Speciale e Kosovës, për katër akuza për krime lufte.

Ata i kanë mohuar akuzat dhe kanë thënë se do të ankohen ndaj aktgjykimit të shkallës së parë në Apelin e Speciales.

Lexo edhe:

[Protesta në Prishtinë/ Ambasada amerikane: Shmangni sheshin "Skënderbeu"](#)

[Shkuan në Hagë në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së, 50 veteranët mbërrijnë në Portin e Durrësit](#)

Dënimi i tyre me burgim është kritikuar ashpër në Kosovë, ku ata shihen si heronj kombëtarë.

Instituti i Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë më 1998-'99 thotë se i ka dokumentuar gjithsej 12.230 viktima të luftës, shumica dërrmuese e tyre shqiptarë të vrarë nga forcat serbe.



TË GJITHA



Mijëra njerëz protestojnë në Prishtinë kundër dënimit të ish-krerëve të UÇK-së për krime lufte

13:45 : 18/09/2026



Turqia miraton marrëveshje bashkëpunimi me Brazilin në industrinë e mbrojtjes

13:42 : 18/09/2026



Ikën Altin Jani, emërohet drejtori i ri i Autoritetit Kombëtar të Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar/ EMRI

13:35 : 18/09/2026



Kultivonte bimë narkotike në mes të pyllit në Mirditë, arrestohet 37-vjeçari

13:26 : 18/09/2026



Shkodër/ 25-vjeçari dëmtohet në kokë në një lokal, nisjet me helikopter drejt Traumës

13:25 : 18/09/2026



BB: Shqipëria shpenzon mbi nivelin e nevojshëm për ujë e kanalizime, por ujë 24 orë nuk ka

13:24 : 18/09/2026



Takimi sekret në Buenos Aires/ Mediat urugaiane: DEA paralajmëron përparimin e mafies shqiptare në rajon

13:03 : 18/09/2026



Një protestues mban një pankartë me mbishkrimin "Ju paralajmërojmë: Padrejtësinë nuk e pranojmë!" gjatë protestës në Prishtinë më 18 shtator kundër dënimit të katër ish-krerëve të UÇK-së nga Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë, më 16 shtator.

Gjatë fjalimit, kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Hysni Gucati, tha se sot "të gjithë jemi UÇK".

"Sot jemi tubuar këtu për ta ngritur zërin kundër një padrejtësie të madhe. Ne sot kërkojmë që këtë vendim Gjykata Speciale ta shfuqizojë dhe ta marrë parasysh këtë popull që është ngritur, tha Gucati.

Në fund të protestës, organizatorët shpalosën katër kërkesa drejtuar Qeverisë dhe Presidencës së Kosovës: Shfuqizimin ose ndryshimin e ligjit për Dhomat e Specializuara; shkarkimin e ministres së Drejtësisë, Donika Gërvalla, mbështetje e pakufizuar dhe fonde të mjaftueshme për mbrojtjen e të pandehurve dhe angazhimin e ekspertëve më të mirë ndërkombëtar në mbrojtje të UÇK-së.

Gërvalla është kritikuar për mungesë reagimi ndaj Gjykatës Speciale për dënimin e ish-krerëve të UÇK-së.

Në protestën që u mbajt në sheshet kryesore të kryeqytetit morën pjesë edhe politikanë të lartë, përfshirë kryetarin e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Bedri Hamza, deputetë të kësaj partie dhe të Aleancës, përfshirë Ramush Haradinajn.

Protestuesit dëgjoheshin duke brohoritur "UÇK" dhe duke mbajtur në dorë pankarta me mbishkrime kundër vendimit të gjykatës.

Mijëra njerëz mbledhen në qendër të Prishtinës për ta kundërshtuar dënimin me burgim të ish-krerëve të UÇK-së nga Gjykata Speciale e Kosovës në Hagë.

Para protestës, Policia e Kosovës u bëri thirrje pjesëmarrësve t'i ndjekin udhëzimet e zyrtarëve policorë, të mos hedhin gjësende e mjete të forta dhe të mos përdorin maska.

Gjatë protestës pranë objektit të Misionit të Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit, EULEX, në Prishtinë, i cili u përfshiu pjesërisht zjarri të mërkurën, kishte protestues të maskuar.

Protesta e së premtes, e thirrur nga Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së, ishte vazhdimësi e protestave të mbajtur në vend qëkurse gjykata i shpalli ata fajtorë.

Një ditë më parë, Thaçi, ish-president i Kosovës, u bëri thirrje qytetarëve ta ruajnë qetësinë pas aktgjykimit dënues ndaj tij dhe bashkëluftetarëve të tij.

Avokati i tij, Luka Mishetiç, përcolli mesazhin e Thaçit të enjten, ku ai falënderoi qytetarët për mbështetjen dhe e cilësoi vendimin e 16 shtatorit të padrejtë.

Për çfarë u dënuan ish-eporët e UÇK-së?

Thaçi, ish-president i Kosovës, dhe Krasniqi, ish-kryetar i Kuvendit të Kosovës, u dënuan me

nga 25 vjet burgim. Veseli, po ashtu ish-kryetar i Kuvendit, u dënua me 18 vjet burgim, ndërsa Selimi, ish-deputet, me 13 vjet.

Trupi gjykues i shpalli ata përgjegjës penalisht për krimet e luftës të ndalimit arbitrar të 385 njerëzve, trajtimit mizor të 49, torturimit të 303, dhe vrasjen e 96 njerëzve.

Sipas aktgjykimit, viktimat përfshinin shqiptarë të Kosovës që konsideroheshin kundërshtarë të UÇK-së, individë që pretendohet se kishin lidhje me Republikën Federative të Jugosllavisë ose autoritetet serbe, si dhe pjesëtarë të caktuar të pakicave etnike, përfshirë një numër romësh dhe serbësh.

Në anën tjetër, që të katërtit u shpallën të pafajshëm për gjashtë akuzat për krime kundër njerëzimit.

Apelimi

Avokati i Thaçit, Mishetiq tha se aktgjykimi dënues do të apelohej në Gjykatën e Apelit në Hagë, pasi pretendoi se ka gabime të rëndësishme ligjore dhe faktike që "kanë cenuar" që procesi gjyqësor "të jetë i drejtë".

Mishetiq shkroi se përgjatë gjithë procesit gjyqësor, mbrojtja ka shprehur shqetësime për drejtësinë procedurale, përfshirë edhe "pyetjet e shumta të bëra nga anëtarët e trupit gjykues që nuk krijojnë përshtypjen e paanshmërisë".

Mbrojtja, sipas tij, argumentuan se gjetjet e trupit gjykues për fajësinë e provuar përtej dyshimit të arsyeshëm mbështeten në prova të pamjaftueshme.

Ndërkohë, edhe Prokuroria mund të ankohet në Apel pasi trupi gjykues i hodhi poshtë akuzat ndaj tyre për krime kundër njerëzimit.

Prokurorja e Specializuar Kimberly West ka thënë se zyra e saj do t'i shqyrtojë edhe këto pjesë të aktgjykimit./ REL

Etiketa: prishine proteste uck

Lajme të lidhura



Protesta në Prishtinë/ Ambasada amerikane: Shmangni sheshin "Skënderbeu"

12:26 : 18/09/2026



Shkuan në Hagë në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së, 50 veteranët mbërrijnë në Portin e Durrësit

10:53 : 18/09/2026




Ç'mund të ndodhë me 7 figurat e UÇK-së që u përmendën në aktgjykimin e 16 shtatorit?

09:58 : 18/09/2026



Mbyllet protesta e 110-të kundër Ramës në Tiranë

22:56 : 17/09/2026



'Jo në emrin tim' / Vlojnë protestat në Prishtinë kundër vendimit të Hagës

22:43 : 17/09/2026



Abilekaj: Gabuam duke i parë serbët si partnerë! Vendimi Hagës na gjeti të gjithëve në faj

22:23 : 17/09/2026

BOLD NEWS

RRETH NESH

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.

Na kontakto:

NA NDIQ

f o y

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.